



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 34 dt. 15.07.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 15.07.2014, pasi shqyrtoi përshkrimin e projektit Linja 110 kV Babicë- Sarandë, diskutuar në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, për “Kërkesa e Operatorit të Sistemit të Trasmetimit, për ndërtimin e linjës 110 kV, Babicë-Sarandë”.

VENDOSI:

1. Operatori i Sistemit të Trasmetimit OST, duhet t’i drejtohet Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik, për të bërë të mundur lidhjen e kontratës dy palëshe, midis subjektit tuaj dhe ASHA-s.
2. Bazuar në nenin 47 të ligjit “Për trashëgiminë kulturore”, jepet miratimi për fillimin e punimeve për Operatorin e Sistemit të Trasmetimit OST, për ndërtimin e linjës 110 kV, Babicë- Sarandë. Për kalimin e linjës është kusht i detyrueshëm:
 - Linjat dhe shtyllat e kësaj linje te vendosen mbi 150 m larg nga objekti Kisha e Shën Marisë Krimarovë, Piqeras.
 - Linjat dhe shtyllat të vendosen mbi 500 m larg nga objekti Kalaja e Borshit
3. Kryerja e të gjithë procedurave të realizohet nën supervizimin e ASHA-s.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR
ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

